

## KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMI EUROPIAN

### Sesioni 1, Grupi i Punës II (Drejtësi, Liri, Siguri)

Tema: **Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit (të rregullt dhe të parregullt): Sfidat në monitorimin dhe përmbushjen e kriterëve ndërkombëtare**

28 SHKURT 2020

#### Zhvillimet aktuale

Grupi i punës vlerësoi si zhvillime pozitive të deritanishme në kuadër të Kapitullit 24: Drejtësi, Liri, Siguri, miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019-2022; e Strategjisë Ndërsektorale të Menaxhimit të Integruar të Kufijve; si dhe Strategjisë së Luftës ndaj Trafikimit të Personave etj.

U konsiderua i suksesshëm aprovimi dhe hartimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit, të cilët po kontribuojnë mbi rritjen e ndërgjegjësimit mbi migracionin; për masat që duhen të merren; përballimin e rritjes së numrit të azilkërkuesve në Shqipëri; për krijimin e një metodologjie të re të përballimit të situatës; për luftën kundër trafikimit të genieve njerëzore; për respektimin e të drejtave të migrantëve dhe për zhvillimin e politikave të reja të migracionit.

**Ligji për të Huajt 108/2013**, pritet të ketë disa ndryshime, marrë shkak nga fluksi i madh i lëvizjes demografike por dhe nga fluksi gjithë e në rritje i azilkërkuesve.

Pritet të ndryshojë dhe **Ligji për Azilin 121/2014** i cili do të harmonizojë gjashtë Direktiva të ndryshme të BE në këtë sektor, direktiva këto të cilat janë miratuar pas vitit 2014.

Është hartuar një propozim për ndryshim të **Ligjit të Kontrollit Kufitar** me synim forcimin e kufijve dhe të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Momentalisht ky propozim është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe pritet të diskutohet nga Komisioni Parlamentar.

Zyrat e sektorit të migracionit nën varësi të Ministrisë së Brendshme, do të veprojnë sipas planit të ri të veprimit dhe strategjisë së re.

Strategjia e re do të monitorohet me një sistem të dyfishtë. Niveli I: Sektori i Migracionit në Ministrinë e Brendshme së bashku me sekretariatit teknik i cili do të kujdeset për zbatimin e planit, dhe në Nivelin II do të jetë: Komiteti Teknik i Migracionit i cili do të kryej monitorim për zbatueshmërinë e strategjisë. Organet e nivelit të dytë kanë fuqi urdhëruese. Pra, Komiteti Teknik ka mundësinë të bëjë propozime dhe rekomandime për caktimin e masave, të cilat do të merren më pas në shqyrtim nga Këshilli i Ministrave.

Tashmë kërkesat për azil do të mund të drejtohen direkt edhe në pikat kufitare dhe jo vetëm në kryeqytet, vendim i cili u pa si pozitiv gjatë debatit.

Ministria e Brendshme Sllovaqe për migracionn bëri një qasje të situatës në Sllovaki dhe problemet e hasura me numrin në rritje të migrantëve sidomos nga Ukraina por dhe me problemet që kishte popullata për të pranuar azilkërkuesit. Ka një ngjashmëri në faktin se Sllovakia ka qenë një vend origjine, pra dërguese siç është Shqipëria sot dhe vazhdon të mbetet kryesisht vend tranzit.

Strategjia e Sllovakisë për Migracionin mban vetëm pikat kuadër e të përgjithshme dhe është e pandryshueshme, por plani i punës ndryshon çdo vit në përshtatje të situatës së migracionit, ku çdo institucion dhe ministri harton çdo vit planin e tij të veprimit ku shtjellohen dhe detajohen pikat bazë të parashikuara në Strategji.

IOM ka qenë një ndihmesë e madhe për të dy shtetet në hartimin e këtyre planeve.

### **Problematika & Rekomandime:**

- Gjatë viteve të fundit ka një rritje aplikimesh për azilkërkues në Shqipëri. Si rezultat i fluksit të madh të azilkërkuesve, nevojitet një mirëmenaxhim i situatës në krijimin e hapësirave dhe kushteve të mjaftueshme për të përballuar kërkesat.
- Grupi i punës sheh si nevojë rritjen e numrit të qendrave efektive pritëse të veçanta fillimisht në jug ( kufiri me Greqinë) dhe më pas në veri të vendit.
- Grupi i Punës rekomandoi realizimin e statistikave dhe të dhënave të sakta rreth numrit të emigrantëve shqiptarë dhe analizim të masave të marra në ndalim të fenomenit. U këshillua të ketë më shumë studime dhe statistika për temën e migracionit, gjithashtu dhe ti jepet më shumë akses publikut në këto studime.
- Marrë shkak nga metodat sllovaqe të veprimit u sugjerua që organet përgjegjëse për migrimin, nga Ministria e Brendshme dhe institucione të tjera të punojnë më shumë për komunikimin dhe informimin e publikut. Një shembull pozitiv nga Sllovakia është përfshirja e një tende/stende të Ministrisë së Brendshme në aktivitete kulturore, panairë apo tubime të ndryshme artistike apo sportive, për të informuar dhe ndërgjegjësuar publikun në lidhje me migracionin.
- Me rëndësi është dhe përfshirja e teknikëve dhe ekspertëve të migracionit në aktivitete dhe programe televizive me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për temën e migracionit dhe azilit.
- U sugjerua dhe Hartimi dhe miratimi i një Strategjie të Komunikimit për zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së migracionit por dhe zhvillimeve që lidhen me këtë fushë.
- Sugjerohet të bëhet një shpërndarje e institucioneve dhe t'i jepet mundësi Komitetit të Migracionit të japë më shumë se thjesht rekomandime.

- Koordinimin mes institucioneve dhe aktorëve kryesorë në çështjet e migracionit dhe azilit është themelor. Ka raste që ka përplasje të interesave mes aktorëve dhe institucioneve, për këtë arsye është i rëndësishëm informimi për masat dhe veprimet si dhe vendosja e një autoriteti koordinues. Ky autoritet do ta bënte më të thjeshtë komunikimin mes institucioneve; përçarjen e informacionit dhe mund të kishte dhe autoritet urdhërues për të përcaktuar vendime të detyrueshme për tu ndjekur e zbatuar nga të gjithë aktorët e përfshirë.
- Për të mundësuar që të gjithë institucionet të luajnë rolin e tyre në menaxhimin e migracionit është e nevojshme ndarja e saktë dhe e qartë e detyrave dhe përgjegjësive për çdo institucion. Për këtë me rëndësi janë realizimi i planeve të veprimit për çdo institucion dhe ndarja e informacionit mes tyre, për të kuptuar rolin dhe përgjegjësinë e secilit.
- Financimi. Në rastin e Sllovakisë, sa i përket çështjeve që lidhen me Migracionin janë më së shumti të financuara nga fondet e Bashkimit Europian. Në Shqipëri situata është e ndryshme ku kjo fushë financohet nga buxheti i shteti dhe shumë pak ka mbështetje nga organizma të tjera ndërkombëtare. Vlerësohet të bëhen përpjekje për të lobuar për më shumë fonde nga BE për të pasur mbështetje në marrjen e masave dhe për një mirëmenaxhim të migracionit.
- Sa i përket procesit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, grupi i punës sugjeroi që duhen marrë parasysh tre elemente gjatë këtij procesi: 1) të merren në konsideratë aspektet specifike të institucioneve, historikut, proceseve dhe kapaciteteve kombëtare; 2) të synohet bashkëpunimi dhe asistenca e Bashkimit Europian dhe vendeve anëtare. Shembull suksesi nga Sllovakia janë Programet Twinning- ku ekspertë të fushës nga institucionet e BE apo nga shtetet anëtare ofrojnë asistencën e tyre; 3) procesi i harmonizimit duhet të zhvillohet në mënyrë graduale duke pasur gjithmonë në vëmendje përditësimet dhe ndryshimet e legjislacionit të BE-së duke qenë që është një fushë mjaft dinamike dhe komplekse. Me rëndësi është gjithashtu që tu kushtohet vëmendje vendimeve që nxjerr GjED;
- Sugjerohet bashkëpunim më i ngushtë dhe me aktorët e tjerë ndërkombëtarë si IOM apo UNHCR si në monitorimin e strategjisë; asistencën teknike dhe ngritjen e kapaciteteve dhe ekspertizës.